



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-057  
Prishtinë, më 30 janar 2019, në orën 15:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 JANAR 2019

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Armend Zemaj, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga Ambasada Amerikane:** Adem Gashi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës.

\* \* \*

### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit**

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 18 janar 2019.

### **2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet formale për shqyrtim në seancë plenare.

Lidhur me përgatitjen e rendit të ditës për seancë plenare diskutuan: Ahmet Isufi, nga GP i AAK-së; Armend Zemaj, nga GP i LDK-së; Glauk Konjufca, nga GP LVV; Memli Krasniqi, nga GP i PDK-së dhe Bilall Sherifi, nga GP Nisma Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me shumicë votash (një votë kundër, Kujtim Shala), vendosi që Kuvendi të mbajë seancë plenare të shtunën, më 2 shkurt 2019, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura,*
2. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zyrtarët publikë,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat në sektorin publik,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe*

*Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256,*

*6. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social,*

*7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019,*

*8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-20 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018,*

*9. Shqyrtimi i Propozim-Statutit të shoqërisë aksionare “Trepça” sh. a.*

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*